REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. i prot / Br. prot. 2467 Më / Dt. 06.07.2026
RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-048, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L222 dhe Ligji Nr. 04/L-116 nenin 58, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 5,7 dhe 8 të rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Nr. 1427, e datës 28.4.2017, dispozitat e nenit 8, 10, 12 dhe 16 të Rregullores MF-Nr, 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 74, dhe nenit 92, paragrafi 4 të statutit të Komunës, Nr 1005, i datës 29.3.2017 dhe Thirrjes Publike të datës 18.6.2026, me numër protokolli 2124, mbi organizimin e festave tradicionale kulturore në Komunën e Rahovecit, të cilat janë: Festa e vjeljes së rrushit 7 shtatori – HardhFest dhe Agrofesta, bazuar në vendimin 7579/60 të datës 01.7.2026 për formimin e Komisionit, për shqyrtimin dhe vlerësimin e Aplikacioneve për ndarje të Subvencioneve për OJQ-të, mbi bazën e thirrjes publike, Komisioni Vlerësues, nxjerr këtë:

# V E N D I M

1. Në përputhje me afatet, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit vlerësues, të përcaktuara me Rregulloren e Lartcekur dhe vendimit të Kryetarit të Komunës dhe mbi bazën e thirrjes Publike të datës 18.6.2026, komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjitha aplikacionet dhe dokumentacionin përkatës të dërguar nga OJQ-të, ku sipas kritereve, Komisioni Vlerësues, ka shpallur fitues për Subvencionim, këtë OJQ:

2.

| Numri | Emrat e OJQ-ve | Shuma |
|---|---|---|
| 1 | **SHOQATA HARDH FEST** | **80,000.00 €** |

3. Pas kalimit të afatit të ankesave dhe të procedurave të tjera të parapara në rregulloret e lartcekura, Kryetari i Komunës, do të lidh kontratat me përfituesit e mjeteve financiare me të gjitha OJQ-të përfituese.

## ARSYETIM

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të, mbi bazën e thirrjes publike dhe në përputhje me Rregulloret e lartcekura, ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni dhe mbi bazën e thirrjes publike nga një (1) aplikacion, kriteret i ka plotësuar vetëm një OJQ.

Në përputhje me detyrat, përgjegjësitë dhe afatet e komisionit, të përcaktuara në Rregulloren e lartcekur dhe duke vlerësuar secilin aplikacion dhe projekt të OJQ-ve, veç e veç, sipas thirrjes publike të datës 18.6.2026.

Nga sa u tha më lart, Komisioni ka vendosur sipas vendimit.

**Udhëzim Juridik:** kundër këtij vendimi lejohet ankesë në afat prej 5 ditësh, në komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave të OJQ-ve në Komunën e Rahovecit.

Datë: 06.7.2026

Anëtarët e Komisionit:

1.1. Dhurata Rrustemi, kryesuese

1.2. Egzon Thaqi, anëtar ____________________

1.3. Flutura Beqiri, anëtare ____________________

1.4. Kaltrina Duraku, anëtare ____________________

1.5. Nazmi Bellaqa, anëtar nga Shoqëria Civile ____________________